



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

VU644-25-4433-5-3-5/C1040

14 Nr. 427/25

Dt. 12.06.2025

ANEKS KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **POROSITËSI**) , dhe
2. **O.E. : “ Risamont “sh.p.k., emri i biznesit, me seli në Prishtinë, me ARBK : 811273424, të cilët i përfaqëson z. Riad Rexhepi , në tekstin e mëtejshëm: KRYESI I PUNËVE, janë pajtuar të lidhin një aneks kontrate publike për punët e shënuara me poshtë: punë shtesë – Renovimi I Palestrës Sportive “ Jeton Tërstena – Tota “ në Vushtrri, me numër identifikues:**

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	44	3	3	5	3	5
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	3	5	5	3	5

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Ka të bëjë me ekzekutimin e punëve shtesë të paraqitura gjetë ekzekutimit të punimeve në ndërtimin respektivisht renovimin e Palestrës Sportive “ Jeton Tërstena – Tota ‘ në Vushtrri, sipas Kontratës së Punës nr. 1151/23 dt. 11.10.2023 dhe sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-4433-535 / VU644-25-035-535**

Afati i fillimit të punimeve është menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.

- 1.2 Projekti do të realizohet brenda periudhës 10 ditë, sipas kushteve të kontratës të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës.
- 1.3 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
- 1.4 Nëse Kryesi i Punëve/Shërbimeve, me përgjegjësinë e tij, nuk arrin *t'i përfundoi ndonjë ose të gjitha punët/ shërbimet e kontraktuara brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të përfundimit të punimeve/shërbimeve sipas kësaj Kontrate dhe datës së përfundimit punëve /shërbimeve të kontraktuara, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së punëve/shërbimeve të pa përfunduara - dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës*

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 4,168.00€ (katërmijnjëqindgjashtëdhjetetë/00Euro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrës i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.4 Paga e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrës i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, e-mail ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.




4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe¹ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për : Autoritetin Kontraktues – Komuna Vushtrri

Për O.E. : “ Risamont “sh.p.k. – Prishtinë

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Riad Rexhepi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.06.2025	Data:	12.06.2025
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.